



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.Shk II.nr.665/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë kundër debitorit Sopa Commerce sh.p.k, me nr. të biznesit 80102356, me seli në Kaçanik, L. Dushkaja, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.151/22 të datës 30.10.2023, me datë **28.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.151/22 të datës 30.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.151/22 të datës 30.10.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Sopa Commerce sh.p.k ashtu që është anuluar Urdhri përmbartimor P.nr. 318/17 i datës 17.07.2017, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Afet Mjeku.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, *(me pretendime sikur në ankesë)*, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të

ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.151/22 të datës 30.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë, ka paraqitur propozim për përmbaremore në bazë të dokumentit aktvendim nr. 1441 i datës 01.06.2015, ashtu që është urdhëruar debitori që për shkak të zhvillimit të aktivitetit ilegal pa posedimin e lejes për aktivitete të veçanta-seperacion, t'ia paguaj kreditorit gjobën administrative sipas aktvendimit të lartcekur në shumë prej 5,000.00 EUR (pesëmijë euro) si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore. Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbaremore duke theksuar se aktvendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbaremore nuk është dokument përmbaremore pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me shqiptim të gjobës dhe se ankimi ndaj këtij vendimi e pezullon ekzekutimin e vendimit deri në marrjen e vendimit nga organi i shkallës së dytë, të cilën ankesë debitori e ka paraqitur. Ka shtuar se shqiptimi i gjobës ndaj pronarit F.S. është në kundërshtim me dispozitat ligjore ngase gjoba i është shqiptuar pronarit, në kundërshtim me nenin 78, par.1 të LSHT-së me të cilin përcaktohet se “Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë dhe e dallueshme nga pronarët” e po ashtu me nenin 80, par.2 ku përcaktohet se “Një pronar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk është përgjegjës për detyrimet e shoqërisë vetëm për arsye se është pronar”.

Kreditori, në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar pretendimet e ngritura nga debitori në prapësim duke theksuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim të organit administrativ i pajisur me vërtetimin e përmbaremeshmërisë dhe i cili është bërë i plotfuqishëm në procedurë administrative, pasi që edhe ankesa e debitorit e ushtruar ndaj këtij aktvendimi është refuzuar. Tutje ka shtuar se pretendimi se shqiptimi i gjobës ndaj pronarit është në kundërshtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare është i pabazuar pasi që në këtë rast, propozimi për përmbaremore i referohet shoqërisë tregtare, pra debitorit “Sopa Commerce”, ndërsa pretendimet tjera debitori ka pasur

mundësi ti ngrit në procedurë administrative dhe në konflikt administrativ. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbarrimit të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.151/22 të datës 30.10.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Sopa Commerce sh.p.k ashtu që është anuluar Urdhri përmbarrimor P.nr. 318/17 i datës 17.07.2017, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Afet Mjeku.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se kreditori nuk është i autorizuar që të kërkoj përmbarrimin ndaj debitorit sipas aktvendimit nr. 1441 i datës 01.06.2015, pasi që Sopa Commerce sh.p.k nuk paraqitet si debitor në dokumentin e lartcekur mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi, por si debitor në këtë dokument paraqitet personi fizik F.S.. Nga kjo rrezulton se Sopa Commerce sh.p.k nuk paraqitet si debitor në aktvendimin e lartcekur andaj, kreditori në kuptim të nenit 71, par.1, nën. par. 1.6 nuk ka autorizim të kërkoj përmbarrimin ndaj debitorit aq më tepër, në regjistrin publik të ARBK-së, tanimë si pronar i subjektit të lartcekur figuron Erblina Çollaku, e cila rezulton të jetë edhe përfaqësuese e autorizuar e debitorit.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë pasi që procedura përmbarrimore është inicuar ndaj debitorit Sopa Commerce, sh.p.k si subjekt juridik ndërsa në Aktvendimin 1441 të datës 01.06.2015, gjoba administrative i është shqiptuar F.S. si person fizik. Andaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka aplikuar nenin 75, par.1 të LSHT-së me të cilin parashihet se “Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët” në lidhje me nenin 78, par. 1, nën-par. 1.1 të LSHT-së përcaktohet se “Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka të drejtat dhe detyrimet në vijim për ushtrimin e Veprimtarisë Ekonomike të saj, duke përfshirë, por pa u kufizuar: të ushtrijë padi ose të jetë e paditur”. Në rastin konkret vdekja e pronarit F.S. nuk paraqet pengese për zhvillimin e procedurës ndaj shoqërisë si person juridik në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura.

Gjykata vlerësoj pretendimet ankimore të kreditorit mirëpo meç të njëjtat nuk ndikuan në vendosjen ndryshë, vendosi që aktvendimin e ankimuar ta vërtetoj. Përndryshe në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor

i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.Shk II.nr. 665/24 , Datë:28.05.2024

Gjyqtarja,

Saranda Bogaj Sheremeti